# Organizim i mirë i qytetit

RAPORTI **2016**

**Prishtina po bëhet**





# Vizioni:

**Vizioni -** Një plan hapësinor për të ardhmen e qytetit. Plan i integruar, funksional, i zbatueshëm dhe i qëndrueshëm për përdorimin afatgjatë të tokës, strukturës ndërtimore, si dhe planifikimin e transportit për tërë qytetin.

**Misioni -** Një mjedis i integruar me një ekonomi në lulëzim, ku të gjithë njerëzit janë të sigurt, të shëndetshëm dhe me mundësi të barabarta; nuk do të ishte i mundshëm nëse nuk marrim parasysh aspektin social, mjedisor, ekonomik dhe kulturor. Komuna e Prishtinës, përkatësisht Drejtoria e Urbanizmit, për të arritur të gjitha këto të mira, ka filluar planifikimin gjithëpërfshirës në këto fusha.

# Mund të sigurohemi për gjërat, vetëm atëherë kur mund t'i shohim në mënyrë të qartë

Konteksti urban është inspirim i mëtutjeshëm për planifikim të qëndrueshëm dhe efikas. Që të kemi këtë "realitet urban" të përfshirë në planifikimin e së ardhmes, Komuna e Prishtinës që nga vitit 2014 e deri në ditët e sotme, ka mbuluar rreth 70% të zonës urbane me incizime gjeodezike. Incizimet gjeodezike janë baza themelore për çdo ndërmarrje planifikuese në shkallë qyteti. Informatat e grumbulluara me këto incizime gjeodezike, paraqesin një qasje sfiduese sa i përket formës dhe mënyrës së paraqitjes. Komuna e Prishtinës i ka filtruar këto informata duke bërë identifikimin dhe unifikimin e tyre, duke krijuar kështu një platformë adekuate për nevojat e saj, e cila do të shërbejë si model për incizimet gjeodezike që do të vinë në vazhdim.




*Figure 1. Fazat e zhvillimit të unifikimit të incizimeve gjeodezike*

**Komuna e Prishtinës ka qenë e sfiduar në vazhdimësi me informatat e paklasifikuara të planeve komunale të niveleve të ndryshme,** informata këto të cilat nuk kanë pasur kritere unifikuese të paraqitjes grafike. Nisur nga kjo, drejtoria përkatëse ka hartuar këto kritere, për të gjitha planet e niveleve të ndryshme komunale. Sa për ilustrim, më poshtë është paraqitur në njërën anë Planin rregullues urban “Tophane”, në mënyrën se si është miratuar, dhe në anën tjetër se si është unifikuar sot. Në mënyrë të tillë janë përfunduar punët në CAD aplikacione dhe GIS: Plani zhvillimor komunal, Plani zhvillimor urban dhe 18 plane rregulluese urbane. Kështu që tani, kemi Plane komunale të niveleve të ndryshme me informatat gjegjëse, por me gjuhë të unifikuar grafike.




*Figure 2. Plani rregullues "Tophane" para unifikimit*




*Figure 3. Plani rregullues "Tophane" pas unifikimit*

# Cila është lidhshmëria në mes të planeve komunale të nivele të ndryshme që janë në fuqi? Cilat janë zonat me potencial më të madh për zhvillim në të ardhmen dhe cila është mënyra më e mirë për identifikimin e kontrasteve në kontekstin e qytetit?

Përmes shkallës së lexueshmërisë dhe krahasimit të këtyre planeve, qyteti i Prishtinës po i minimizon problematikat që po e vështirësojnë zbatueshmërinë e po këtyre planeve.




*Figure 4. Mbishtresimi i planeve zhvillimore dhe rregulluese urbane, krahasimet dhe dallimet*

# Kushtet ndërtimore për secilën parcelë

Çdo qytetar gëzon të drejtën për të qenë i informuar mbi planifikimin. Informimi i lehtë përmes sistemit 'online', do iu mundësojë qytetarëve të informohen për kushtet ndërtimore për cilëndo parcelë kadastrale. Kushtet dhe kriteret specifike do të qartësohen përmes tabelave, të cilat do të paraqiten me të gjitha informatat e saktësuara mbi destinimin, përmbajtjen, rregullativin për ndërtimin, kushte zhvillimore dhe ndërtimore etj.




*Figure 5. Kushtet dhe kriteret për secilën parcelë*

# Identifikimi i të gjitha pronave komunale

Që Komuna të mund të planifikojë infrastrukturën publike/sociale, ka qenë e rëndësishme të dihen se cilat janë pronat publike. Shtrirja e tyre grafike në hartën përkatëse dhe mbushja e tabelave me atribute mbi informacionet që vet prona i posedon, janë vetëm disa nga hapat që mundësojnë informim më të shpejtë dhe qasje shumë më të lehtë.




*Figure 6. Pronat Komunale*

# Identifikimi i të gjitha pronave komunale

*Transferi i të drejtave ndërtimore na ndihmon në kuptimin e:*

- *metodologjive të transferit të koeficientave të ndërtimit nga një vend në vendin tjetër, duke ruajtur interesin publik;*
- *kthimin e pronës private në pronë publike, me marrëveshje.*




*Figure 7. Metodat dhe hulimitimet rreth perfitimit të hapësirës publike*

## "Emocioni, hapësirën e shndërron në ambient. Hapësira duhet të jetë e qasshme dhe e organizuar për të ndërtuar emocion, dhe kësisoj bëhet ambient publik"

Hapësira publike konsiderohet të jetë hapësirë "gjithëpërfshirëse", në të cilën të gjitha grupmoshat kanë të drejtë qasjeje. Kualiteti i hapësirës publike konsiderohet i suksesshëm, nëse arrijmë të krijojmë një mjedis në të cilën qytetarët duan të jetojnë dhe të punojnë. Andaj Komuna e Prishtinës për të krijuar këto hapësira të hapura publike, paraprakisht është dashur që ta bëjë identifikimin e tyre për tërë territorin e zonës urbane. Këto hapësira publike janë identifikuar në bazë të incizimeve gjeodezike dhe daljeve në terren. Në këtë platformë, janë përfshirë edhe të gjitha hapësirat e planifikuara me planet komunale të niveleve të ndryshme. I gjithë ky material është i ndërtuar në një platformë nga 18 grupe, me 188 shtresa (me bazë CAD aplikacioneve dhe GIS).




*Figure 8. Profilit të hapësirave publike*

# Procesit të krijimit të hapësirave të reja, i paraprinë procesi i mirëmbajtjes së hapësirave ekzistuese.

Që të mund të kontrollohen më mirë investimet dhe menaxhimi i secilës hapësirë publike me të gjitha specifikat e tyre përkatëse, ka qenë e nevojshme që të përpilohen planet e mirëmbajtjes së këtyre hapësirave. Kjo është arritur me mbështetjen e projektit DEMOS dhe Komunës së Prishtinës. Fillimisht është punuar në dy projekt-pilote, në lagjet "Dardania" dhe "Ulpiana", për të vazhduar me të gjitha hapësirat publike të qytetit të Prishtinës.




| Emri i HHP | | Pershkrimi i aktivitetit | [illegible] | Sasia | | [illegible] | Çmimi total (vjetor) | Nr i Aktiviteteve (vjetore) | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| HHP-2_HPKKB-UL | AP | Grumbullimi dhe largimi i mbeturinave sipas specifikimit teknik | m² | 36650.2 | € | 0.0015 | 20,065.99 | 365 | 31 | 28 | 31 | 30 | 31 | 30 | 31 | 31 | 30 | 31 | 30 | 31 |
| | AP | Pastrimi i shtigjeve te kembesoreve nga bora,sipas specifikimit teknik | m² | 7343 | € | 0.02 | 1,174.88 | 8 | 2 | 2 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 2 |
| | H | Ujitje e siperfaqes gjelbruese sipas specifikimit teknik | m² | 26948 | € | 0.02 | 14,956.14 | 37 | 0 | 0 | 1 | 4 | 6 | 6 | 6 | 6 | 6 | 2 | 0 | 0 |
| | H | Kositja e barit sipas specifikimit teknik | m² | 26948 | € | 0.02 | 6,871.74 | 17 | 0 | 0 | 1 | 2 | 3 | 2 | 2 | 1 | 2 | 2 | 2 | 0 |
| | H | Plehrimi i fidaneve sipas specifikimit teknik | copë | 254 | € | 0.50 | 127.00 | 1 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | H | Mihja e gjelbrimit te ulte-luleve sipas specifikimit teknik | m² | 269.48 | € | 0.05 | 13.47 | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | H | Mbjellja e gjelberimit te ulte/luleve sipas specifikimit teknik | copë | 26948 | € | 0.50 | 13,474.00 | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | H | Mirembajtja e gjelberimit te larte/Krositja e drunjeve sipas specifikimit teknik | copë | 254 | € | 10.00 | 2,540.00 | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | H | Dezinfektimi,dezinsektimi dhe deratizimi sipas specifikimit teknik | m² | 26948 | € | 0.01 | 269.48 | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | AN | Mirembajtja e mobilerise urbane-Ulset sipas specifikimit teknik | copë | 40 | € | 15.00 | 600.00 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | AN | Mirembajtja e mobilerise urbane-Shportat i sipas specifikimit teknik | copë | 57 | € | 15.00 | 855.00 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | AN | Riparimi shtigjeve me kubeza ne rast demtimi sipas specifikimit teknik | m² | 73.43 | € | 9.00 | 660.87 | 1 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | AN | Mirembajtja e ndriqimit sipas specifikimit teknik | copë | 57 | € | 0.50 | 57.00 | 2 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 |
| | AN | Mirembajtja e lodrave ne kendet e lodrave per femije | copë | 15 | € | 2.00 | 60.00 | 2 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | AN | Riparimi i lodrave ne kendet e lodrave per femije | copë | 15 | € | 20.00 | 300.00 | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | AN | Mirembajtja e fushes sportive sipas specifikimit teknik (Rrethoja) | m² | 138 | € | 1.00 | 138.00 | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | AN | Riparimi i koshave ne fushen sportive sipas specifikimit teknik | copë | 2 | € | 5.00 | 10.00 | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | AN | Mirembajtja e fushes sportive sipas specifikimit teknik (Shenjezimi) | m² | 138 | € | 1.00 | 138.00 | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | AN | Mirembajtja e fushes sportive sipas specifikimit teknik (Ndricimi) | copë | 6 | € | 0.50 | 3.00 | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | AN | Mirembajtja e permendores sipas specifikimit teknik | m² | 9.1 | € | 0.50 | 9.10 | 2 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 |
| | | | | | | € | 62,323.68 | | | | | | | | | | | | | |

*Figure 9. Zona 2, Ulpiana, plani i mirëmbajtjes*

# Çfarë ndodhë nën hapësirën që frekuentojmë?!

Për të pasur një pasqyrë të qartë të të gjithë rrjetit mbitokësor dhe nëntokësor dhe kompanive publike që monitorojnë me këtë rrjet, në bashkëpunim me këto kompani (KOSST, KEDS, PTK, KUR Prishtina), është përpiluar harta e kadastrit të infrastrukturës teknike mbitokësore dhe nëntokësore, hartë kjo e cila ndihmon në planifikimin efikas të qytetit.



*Figure 10. Infrastuktura Teknike*

# Çerdhe publike në çdo cep të qytetit

Në bazë të analizave të mbulueshmërisë dhe statistikave banimore dhe të institucioneve të niveleve të ndryshme arsimore, është konstatuar nevoja e madhe e këtyre institucioneve, sidomos të nivelit parashkollor – çerdhe/kopsht. Kjo nevojë është e theksuar në lagjet periferike, pasi që pjesa dërmuese e këtyre institucioneve ekzistueseve janë koncentruar në lagjet qendrore të qytetit. Si rrjedhojë e këtij konstatimi, janë ndërmarrë hapa konkret në plotësimin e nevojave të çdo qytetari në të drejtën e arsimimit parashkollor.

Pas vlerësimit të nevojave për çerdhe në të gjitha lagjet dhe fshatrat e komunës së Prishtinës, është përgatitur plani aksional për hapjen e çerdheve të reja, me çmim të përballueshëm, në çdo pjesë të Prishtinës. Deri më tani janë hapur këto çerdhe në lagjet që janë identifikuar në bazë të vlerësimit të nevojave:

- ✓ Çerdhja "**Botanika**", në lagjen "**MATI II"** – 80 fëmijë;
- ✓ Çerdhja "**Ngjyrat**", në lagjen "**Hajvalia"** – 40 fëmijë;
- ✓ Çerdhja "**Shtëpia Magjike**", në fshatin **Besi** – 40 fëmijë;
- ✓ Çerdhja "**Shkronjat**", në lagjen "**Arbëria III"** – 106 fëmijë;
- ✓ Është në proces të hapjes çerdhja "**Zogjtë**", në lagjen "**Sofalia"** – 70 fëmijë;
- ✓ Është në përfundim ndërtimi i çerdhes në lagjen "**Kodra e Trimave"** – 240 fëmijë;
- ✓ Ka filluar renovimi i objektit për hapjen e çerdhes në lagjen "**Tophane"** – 60 fëmijë;



*Figure 11. Analiza e mbulueshmërisë për çerdhe dhe shkolla fillore të mesme të ulëta dhe të mesme të larta*

# T'i mbrojmë vlerat kulturore të qytetit tonë.

Duke marrë parasysh që në komunës e Prishtinës gjenden 135 asete të trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme dhe të përkohshme, dhe shtrirja e tyre është e koncentruar në zonat me potencial të lartë ndërtimor, në mënyrë që të mos lëshohen gabime të mundshme gjatë ndërtimeve në këto zona, është përpiluar harta e këtyre aseteve, duke u bazuar në incizime gjeodezike. Është bërë identifikimi dhe gjeo-referencimi i këtyre aseteve, zonës mbrojtëse, ashtu siç është përcaktuar me ligjin përkatës, si dhe parcelave kadastrale në të cilat shtrihen këto asete. Përveç asete të trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme dhe të përkohshme, është bërë edhe identifikimi i aseteve potenciale të trashëgimisë kulturore.

Shembull (BIBLOTEKA KOMBËTARE E KOSOVËS)




*Figure 12. Gjeoreferencimi, zona e mbrojtjes dhe parcelat kadastrale të aseteve të trashëgimisë kulturore*

# Vendosja e rregullit në planifikim urban

**Vizioni:** "Qytet që u ofron qytetarëve mundësi të lehta në qasje dhe informim".

**Misioni:** Sfida më e madhe në informimin e saktë të qytetarit, është veprimi që Komuna e Prishtinës e aplikon në përgjigje të shpejta dhe me transparencë të lartë.

## Një qytet legal

Njëri ndër qëllimet kryesore të Komunës së Prishtinës ka qenë procesi i legalizimit, proces ky i cili ka filluar në shkurt të vitit 2014, me fazën e parë - identifikimin dhe regjistrimin e të gjitha ndërtimeve pa leje në sistemin GIS, ku janë identifikuar 46523 ndërtime pa leje, dhe ka vazhduar me fazën e dytë-aplikimin për pajisje me leje ndërtimore, në shkurt të vitit 2015-të, proces ky i cili ka përfunduar në mars të vitit 2016. Nga ky proces gjithsej kemi 6868 aplikime për legalizim, 6100 të trashëguara si lëndë të papërfunduara dhe 768 aplikime të reja. Deri sot, është arritur të legalizohen 178 ndërtime, vetëm 1 ndërtim nuk i ka plotësuar kriteret për legalizim dhe 44 ndërtime të papërfunduara janë të bartura për trajtim në Drejtorinë e Urbanizmit, sipas ligjit përkatës.

# Transparencë në punë

Duke u përpjekur që të jemi transparent dhe çdo qytetar të ketë qasje në punët e drejtorive është bërë dhe Publikimi i Lejeve të Ndërtimit në ueb-faqen e komunës. Për vitin 2013 kemi 112 leje ndërtimore të publikuara, për vitin 2014 kemi 83 leje ndërtimore të publikuara nga gjithsejtë 84 leje ndërtimore të lëshuara, për vitin 2015 kemi 158 leje ndërtimore të publikuara nga gjithsejtë 159 leje ndërtimore të lëshuara, kurse në vitin 2016 kemi 138 leje ndërtimore të publikuara deri më tani nga gjithsej 149 leje ndërtimore të lëshuara në këtë vit.

Lista e lejeve të lëshuara për vitin 2015 : Lista e lejeve të lëshuara për vitin 2015

**Komuna e Prishtinës - Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit - Lejet e lëshuara 2015**

**Qytetarë të nderuar, këtu i keni të gjitha lejet e lëshuara për vitin 2015. Nëse nuk gjendet ndonjë leje në këtë tabelë, atëherë ndërtimi për të cilin ju intereson nuk ka leje ose është në proces të lejës.**

**Procesin e lëndëve mund ta gjeni duke klikuar këtu një kolonë më poshtë.**

**Procesi i lëndëve**

PRISHTINA

| # | Data e lëshimit të lejes | Pronari / Pronarët (Përfaqësuesi) | Kompania / Investitori | Projektuesi | Lagja | Sipërfaqja totale ndërtimore | Pagesa totale e lejës së lëshuar | Etazhiteti | Koment | Dokumenti në PDF i lejës së lëshuar | Situacioni i ndërtimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 28.10.2015 | Hatixhe Islami, Naze Islami, Isak Islami, Ismet Islami, Rasim Sogojeva, Ahmet Avdullahi, Rasim Magjera, Fatime Isufi, Albert Bakiu, Fehmi Toplica, Shemsi Toplica, Tomor Toplica, Gëzim Toplica, Latif Haxhilari, Sitki Haxhilari, Hasan Ramadani, Nifa Islami, Fatmir Islami, Sabit Islami, Xhevrije Emini, Muhamed Avdullahi, Skender Hoti, Ismet Avdullahi & Ahmet Avdullahi | N.T.P. "Premtimi" | N.T.P. "Pro Joni" | Tophane | 11,247.30m² | €201,564.04 | 2B+P+10, 3B+P+12 | Objekte shumë banesore & afarizëm | Leja me nr. 05-351-191614 | Situacioni |
| 2 | 26.10.2015 | Petrit Deshishku | Petrit Deshishku | N.N.P.T "Lesna Ing Af" sh.p.k | Zona Industriale (Fushë Kosovë) | 2844.38m² | €56,887.60 | B+P+1 | Objekt Afarist | Leja me nr. 05-351-206693 | Situacioni |
| 3 | 23.10.2015 | Ramiz, Sefedin, Selatin, Avni, Zeqir dhe Rrahime Mehmeti | "AGIKOS" | N.SH.P. "AS PROJECT" | Arbëria 3 | 3968.30m² | €107,702.86 | B+S+P+6 | Objekt shumë banesor & afarizëm | Leja me nr. 05-351-44919 | Situacioni |
| 4 | 23.10.2015 | Jeton Gashi | Jeton Gashi | N.T.SH. "HB & KUÇI" | Hajvali | 239.66m² | €2,243.22 | P+1 | Objekt Individual | Leja me nr. 05-351-122792/1 | Situacioni |
| 5 | 23.10.2015 | Hajrije Krasniqi | Hajrije Krasniqi | "AVDax Studio" sh.p.k | Bërnicë e Epërme | 439.33m² | €8,786.77 | P+1 | Objekt Individual | Leja me nr. 05-351-190928 | Situacioni |
| 6 | 23.10.2015 | Hysen Kavaja | Hysen Kavaja | "3E" sh.p.k | Ulpiane | 74.00m² | €3,681.50 | B+P+4 | Ndërrim destinimi nga hapësirë banesore në hapësirë afariste | Leja me nr. 05-351-185115 | Situacioni (2 PDF) |
| 7 | 21.10.2015 | Endrit, Avdi, Ismet, Ilir dhe Sylejman Gashi & Hanumsha Gashi-Spahiu & Agron Bogiqi | "Jon" sh.p.k | "Jon" sh.p.k | Kalabria | 24,682.20m² | €416,412.96 | 2B+P+8, 2B+P+8, 2B+5 | Objekte shumë banesore & afarizëm | Leja me nr. 05-351-183584 | Situacioni |
| 8 | 19.10.2015 | Misin Voci, Kushtrim Ismajli, Gazmend Ahmetaj & "Arena" sh.p.k | "Arting" sh.p.k | "LSN ARKITEKT" sh.p.k | Lakrishte | 15,658.76m² | €126,150.08 | P+20 | Objekt shumë banesor & afarizëm | Leja me nr. 05-351-60250/1 | Situacioni |
| 9 | 19.10.2015 | Ekrem Dreshaj | Ekrem Dreshaj | N.P.N.T. "AGA" | Prishtina e Re - Zona Perëndim | 218.00m² | €2,040.48 | P+1 | Objekt Individual | Leja me nr. 05-351-199043 | Situacioni (2 PDF) |
| 10 | 12.10.2015 | Arian Rexhepi | Arian Rexhepi | "FF GROUP" sh.p.k | Çagllavicë | 317.30m² | €2,808.00 | P+1 | Objekt Individual | Leja me nr. 05-351-206757 | Situacioni |
| 11 | 09.10.2015 | Ramiz, Sefedin, Selatin, Avni, Zeqir dhe Rrahime Mehmeti | N.T.P. "Butrinti" | N.SH.P. "AS PROJECT" | Arbëria 3 | 3109.70m² | €134,040.42 | B+S+P+6 | Objekt shumë banesor & afarizëm | Leja me nr. 05-351-196001 | Situacioni |
| 12 | 06.10.2015 | Rrahman Hoti & Osman Huseni | N.N.T. "NDËRTIMI - A" | "Infra-Ing" sh.p.k | Mati 1 | 6555.16m² | €114,496.36 | 2B+P+6, 2B+P+6 | Objekte shumë banesore & afarizëm | Leja me nr. 05-351-283508 | Situacioni |
| 13 | 06.10.2015 | Besim Barbatovci | Besim Barbatovci | "Struktura" | Kalabria | 140.62m² | €1,316.20 | P+0 | Objekt Individual | Leja me nr. 05-351-205377 | Situacioni |
| 14 | 05.10.2015 | Shefkate Kulinxha, Bahtije Ajvazi, Bejtush, Ismet, Gafurr, Fahri, Shukri, Burim, Veli, Bujar dhe Behar Blakqori | "TED AF" sh.p.k | N.SH. "Blakaj Arkitekture" | Kalabria | 7901.57m² | €141,255.46 | 2B+P+8 | Qendër Afariste | Leja me nr. 05-351-182364 | Situacioni |
| 15 | 02.10.2015 | Avni, Selatin, Zeqir, Rrahime, Ramiz dhe Sefedin Mehmeti | "Arti Group" sh.p.k | N.SH.P "AS PROJECT" | Arbëria 3 | 5479.29m² | €102,029.40 | B+P+6+Nk | Objekt shumë banesor & afarizëm | Leja me nr. 05-351-150902 | Situacioni |
| 16 | 02.10.2015 | Skender Rrahmani | Skender Rrahmani | "Aspen Architecture" sh.p.k | Kodra e Trimave 2 | 244.12m² | €2,284.96 | P+1 | Objekt Individual | Leja me nr. 05-351-164144 | Situacioni |
| 17 | 01.10.2015 | Ministria e punëve të Brendshme - Agjencia e Menaxhimit Emergjent | Ministria e punëve të Brendshme - Agjencia e Menaxhimit Emergjent | N.P.N "3L ING" | Hajvali | 6503.76m² | Lirohen nga pagesa | B+P+2, P+2, P+2 | Kompleks Administrativ | Leja me nr. 05-351-94985 | Situacioni |
| 18 | 01.10.2015 | "Royal" sh.p.k | "Royal" sh.p.k | N.SH. "Rraci Ark Ing" | Mati 1 | 21,834.00m² | €374,595.60 | 2B+S+P+8, 2B+S+P+8, 2B+S+P+7 | Obejkte shumë banesore & afarizëm | Leja me nr. 05-351-191351 | Situacioni |
| 19 | 28.09.2015 | Zenun Pajaziti | Zenun Pajaziti | "AVDax Studio" sh.p.k | Prishtina e Re - | 450.49m² | €9,009.80 | P+1+Nk | Objekt Individual | Leja me nr. 05-351-129038 | Situacioni |

Published by Google Sheets – Report Abuse – Updated automatically every 5 minutes

*Publikimi i lejeve në ueb faqen e Komunës së Prishtinës*

# Lehtësim i procedurave për qytetarë

Për të lehtësuar dhe thjeshtësuar procedurat për qytetarë, është lansuar shërbimi ‘online’ për informata nga planet e niveleve të ndryshme komunale, ku gjatë vitit 2016 janë lëshuar rreth 1300 informime ‘online’.




*Aplikimi online*

Gjithashtu, në këtë aspekt janë nënshkruar dhe marrëveshje mirëkuptimi ndërinstitucionale, si “One Stop Shop” në mes Ministrisë se Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, Komunës së Prishtinës, kompanisë së ujësjellësit rajonal – KUR “Prishtina” dhe Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike - KEDS Sh.a.
Është bërë publikimi i udhëzueseve për qytetarë në aspektin e informimit të procedurave dhe dokumentacionit të nevojshëm për pajisje me kushte dhe leje ndërtimore.




*Procedurat për pajisje me kushte dhe leje ndërtimore*

# Digjitalizimi i arkivit si platformë dhe arkivimit si proces

Produkti final, është një Data-bazë në GIS, e cila ka të inkorporuar të gjithë Arkivin e digjitalizuar si tërësi (Arkivin e dosjeve të lëndëve bashkë me Arkivin e dosjeve të projekteve). Plotësimi i mëtutjeshëm i kësaj Data-bazë është tejet i thjeshtë. Kjo Data-bazë është shumë lehtë e qasshme, kështu që përpos përdorimit të brendshëm në kuadër të Drejtorisë, mund të ofrohet edhe për përdorim të publikut 'online' për një numër të konsiderueshëm arsyesh. Kjo Data-bazë si e tillë, do të lidhet si pjesë përbërëse e Data-bazave të tjera paralele të GIS-it në kuadër të drejtorive përkatëse.







*Databaza e arkivës- paraqitja nw sistemin GIS*

Prishtina
po bëhet